



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIVJAKË
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Divjakë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje karburanti për nevojat e Bashkisë Divjakë për vitin 2025”
Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat nga momenti i nënshkrimit të kontratës deri më 31.12.2025

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): CPV 09100000-0 Karburante

VLERA E FONDIT LIMIT: 34 955 097 (tridhjetë e katër milion e nëntëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e nëntëdhjetë e shtatë) lekë pa Tvsh, nga e cila:

- 33 335 380 (tridhjetë e tre milion e treqind e tridhjetë e pesë mijë e treqind e tetëdhjetë) lekë pa Tvsh për Naftë

- 1 619 717 (një milion e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e shtatëmbëdhjetë) lekë pa Tvsh për Benzinë, i ndarë si më poshtë:

Vlera e fondit limit ne monedhen nderkombetare euro sipas kursit te Bankes se Shqiperise eshte 353 797 (treqind e pesedhete e tre mije e shtateqind e nentedhete e shtate) euro pa tvsh .Kursi zyrtar i kembimit sipas Bankes se Shqiperise per monedhen euro ne date 11.10.2024 eshte 98.80

Mjetet e Bashkisë Divjakë:

- 14 274 059 (katërmëdhjetë milion e dyqind e shtatëdhjetë e katër mijë e pesëdhjetë e nëntë) lekë pa Tvsh për Naftë, (Kodi i programit 01110, Grupi 00, Llogaria ekonomike 602, Kodi projektit 9999999).
- **Kapitulli 01** - 11 416 667 (njëmbëdhjetë milion e katërqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) leke pa Tvsh
- **Kapitulli 05** - 2 857 392 (dy milion e tetëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e treqind e nëntëdhjetë e dy) lekë pa Tvsh.

Vlera e fondit limit per Mjetet e Bashkisë Divjakë ne monedhen nderkombetare euro sipas kursit te Bankes se Shqiperise eshte 144 474 (njeqind e dyzet e kater mije e katerqind e shtatedhete e kater)

euro pa tvsh .Kursi zyrtar i kembimit sipas Bankes se Shqiperise per monedhen euro ne date 11.10.2024 eshte 98.80

Sektori Turizmit:

- 957 407 (nëntëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e shtatë) lekë pa Tvsh për Benzinë dhe 1 148 889 (një milion e njëqind e dyzete e tetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e nente) lekë me Tvsh për Benzinë për Sektorin e turizmit (Kodi i programit 04130, Grupi 00, Llogaria ekonomike 602, Kodi projektit 9999999)
 - Kapitulli 01 - 750 000 (shtatëqind e pesëdhjetë mijë) leke pa Tvsh dhe
 - Kapitulli 05 - 207 407 (dyqind e shtatë mijë e katërqind e shtatë) leke pa Tvsh

Vlera e fondit limit per Sektori Turizmit ne monedhen nderkombetare euro sipas kursit te Bankes se Shqiperise eshte 9 690 (nente mije e gjashteqind nentedhjetë) euro pa tvsh .Kursi zyrtar i kembimit sipas Bankes se Shqiperise per monedhen euro ne date 11.10.2024 eshte 98.80

Agjensinë e Shërbimeve Komunale, Bashkia Divjakë:

- 11 128 143 (njëmbëdhjetë milion e njëqind e njëzete e tetë mijë e njëqind e dyzetë e tre) lekë pa Tvsh (Kodi i programit 06260, Grupi 00, Llogaria ekonomike 602, Kodi projektit 9999999), nga e cila:
 - 10 892 183 (dhjetë milion e tetëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e njëqind e tetëdhjetë e tre) lekë pa Tvsh për Naftë
 - Kapitulli 01 - 8 333 333 (tetë milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa Tvsh.
 - Kapitulli 05 - 2 558 850 (dy milion e pesëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e pesëdhjetë) lekë pa Tvsh
 - 235 960 (dyqind e tridhjetë e pesë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa Tvsh për Benzinë
 - Kapitulli 05 - 235 960 (dyqind e tridhjetë e pesë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa Tvsh

Vlera e fondit limit per Agjensinë e Shërbimeve Komunale, Bashkia Divjakë ne monedhen nderkombetare euro sipas kursit te Bankes se Shqiperise eshte 112 633 (njeqind e dymbedhjetë mije e gjashteqind e tridhjetë e tre) euro pa tvsh .Kursi zyrtar i kembimit sipas Bankes se Shqiperise per monedhen euro ne date 11.10.2024 eshte 98.80

Drejtorinë e Infrastrukturës, Sektori Ujitje - Kullim:

- 6 182 617 (gjashtë milion e njëqind e tetëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e shtatëmbëdhjetë) lekë pa Tvsh, nga e cila:
 - 5 887 667 (pesë milion e tetëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa Tvsh për Naftë, (Kodi i programit 04240, Grupi 00, Llogaria ekonomike 602, Kodi projektit 9999999, Kapitulli 01)
 - 294 950 (dyqind e nëntëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) lekë pa Tvsh për Benzinë, (Kodi i programit 04240, Grupi 00, Llogaria ekonomike 602, Kodi projektit 9999999, Kapitulli 01)

Vlera e fondit limit per Drejtorinë e Infrastrukturës, Sektori Ujitje - Kullim ne monedhen nderkombetare euro sipas kursit te Bankes se Shqiperise eshte 62 577 (gjashtedhjetë e dy mije e

peseqind e shtatedhjetete shtate) euro pa tvsh.Kursi zyrtar i kembimit sipas Bankes se Shqiperise per monedhen euro ne date 11.10.2024 eshte 98.80

Drejtorinë e Infrastrukturës, Sektori i Rrugëve Rurale:

- 1 133 376 (një milion e njëqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa Tvsh për Naftë (Kodi i programit 04520, Grupi 00, Llogaria ekonomike 602, Kodi projektit 9999999, Kapitulli 01)

Vlera e fondit limit per Drejtorinë e Infrastrukturës, Sektori i Rrugëve Rurale ne monedhen nderkombetare euro sipas kursit te Bankes se Shqiperise eshte 11 471 (njembedhjetete mije e kateqind e shtatedhjetete e nje) euro pa tvsh.Kursi zyrtar i kembimit sipas Bankes se Shqiperise per monedhen euro ne date 11.10.2024 eshte 98.80

Për Sektorin e MZSH-së:

- 1 187 913 (një milion e njëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e nentëqind e trembedhjetë) lekë pa Tvsh (Kodi i programit 03280, Grupi 00, Llogaria ekonomike 602, Kodi projektit 9999999, Kapitulli 01), nga e cila:
 - 1 148 095 (një milion e njëqind e dyzetë e tete mije e nëntëdhjetë e pesë) lekë pa Tvsh për Naftë
 - 39 818 (tridhjetë e nëntë mijë e teteqind e tetëmbëdhjetë) lekë pa Tvsh për Benzinë

Vlera e fondit limit për Sektorin e MZSH-së ne monedhen nderkombetare euro sipas kursit te Bankes se Shqiperise eshte 12 023 (dymbëdhjetete mije e njezet e tre) euro pa tvsh.Kursi zyrtar i kembimit sipas Bankes se Shqiperise per monedhen euro ne date 11.10.2024 eshte 98.80

Drejtorinë e Bujqësisë, Mjedisit, Veterinarisë dhe Pyjeve:

- 91 582 (nëntëdhjetë e një mijë e pesëqind e tetëdhjetë e dy) lekë pa Tvsh për Benzinë (Kodi i programit 04260, Grupi 00, Llogaria ekonomike 602, Kodi projektit 9999999, Kapitulli 01)

Vlera e fondit limit për Drejtorinë e Bujqësisë, Mjedisit, Veterinarisë dhe Pyjeve ne monedhen nderkombetare euro sipas kursit te Bankes se Shqiperise eshte 927(nentëqind e njezet e shtate) euro pa tvsh.Kursi zyrtar i kembimit sipas Bankes se Shqiperise per monedhen euro ne date 11.10.2024 eshte 98.80

Burimi i financimit: **Granti + Të ardhurat**

- 29 095 488 (njëzetete e nëntë milion e nëntëdhjetë e pesë mijë e katërqind e tetëdhjetë e tetë) lekë pa Tvsh nga Granti nga e cila:
- 27 919 138 (njëzetë e shtatë milion e nëntëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e njëqind e tridhjetë e tetë) lekë pa Tvsh për Naftë
- 1 176 350 (një milion e njëqind e shtatëdhjetete e gjashtë mije e treqind e pesëdhjetete) lekë pa Tvsh për Benzinë
- 5 859 609 (pesë milion e tetëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e nëntë) lekë pa Tvsh nga Të ardhurat, nga e cila:
- 5 416 242 (pesë milion e katërqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e dyqind e dyzetë e dy) lekë pa Tvsh për Naftë
- 443 367 (katërqind e dyzete e tre mijë e treqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa Tvsh për Benzinë

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Divjakë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas shtojcës 4

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 77, 82 dhe 83 të LPP dhe nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, njësia e prokurimit bazuar në natyrën e kontratës, si edhe preventivin, gjykon që pjesë e kriterëve të veçanta për kualifikim të jenë dhe kriteret e tjera teknike, me qëllimin kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor ndër të tjera për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve teknike, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, reputacionin dhe besueshmërinë, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës, konkretisht njësia e prokurimit gjykon vendosjen e kriterëve si vijon:

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1 Sipas Shtojcës 8, pika 1 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, si edhe në nenin 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim nga administrata tatimore për xhiron e realizuar në 3 (tre) vitet e fundit 2021 2022 dhe 2023 nga shoqëria, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së përllogaritur të kontratës që po prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe nenin 43 pika 1, pika 2/b dhe pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, pika 1 citon: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare, ndërsa në pikën 2/b citohet: vlerën e përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar, ndërsa në pikën 3 citohet: Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse*

operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues, i sherben Autoritetit Kontraktor, per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten. Gjithashtu vendosja e kriterëve ne reference eshte bere që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, në nenin 77, pika 3 e LPP, ne nenin 43 pika 1, pika 2/b dhe pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ne Ligjin Nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në republikën e shqipërisë” i ndryshuar, si edhe në Ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. Ky kriter kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten.

Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2/b, të Nenit 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Ky kriter kualifikues, i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për vitin 2023 dhe detyrimet e maturuara për vitin 2024.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 të DST.

Shenim: Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor, referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si edhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Kjo kërkesë është bërë në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, sipas të cilit, operatorët ekonomikë duhet të shlyejnë detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në çdo adresë ku ushtrojnë aktivitetet.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës që po prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që po prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vlera e kërkuar është vendosur që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së furnizimeve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

Shënim: Autoretiti /enti kontraktor mund të kërkojë edhe:

2.4. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të jetë i pajisur me Licencë të tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse, për përdorim nga konsumatorët fundorë nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) ose Autorizim për ushtrim aktiviteti “Tregti me pakice të lëndëve djegëse Karburante”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në nenin 40, pika 5, gërma a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, i cili përcakton se: *“Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.* Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore. Gjithashtu, kjo kërkesë është bazuar dhe në Ligjin Nr.8450 dt.24.02.1999 “Për përpunimin, transportin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre” si dhe në VKM nr.970 datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.4.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë leje për minimumi 1 (nje) pike shitje karburanti të provuar me dokument ligjor (ekstrakti tregtar i QKR-se, Certifikate pronësie ose dokument tjetër ligjor) në territorin e Bashkisë Divjake, gjithashtu operatori ekonomik duhet të ketë kontratë bashkpunimi/kontratë qiraje ose në pronësi me të paktën një pike furnizimi, të vertetuara këto me kontratë qiraje, kontratë bashkpunimi ose dokument pronësie me afat vlefshmerie për të gjithë afatin e zbatimit të kontratës për këtë objekt prokurimi në një distancë jo më shumë se 60 km nga godina e Bashkisë Divjake.

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si edhe nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Kërkesa e mësipërme, është e nevojshme për garantimin e furnizimit me karburant të mjeteve motorike pa pasur nevojë të bëhen shumë kilometra vetëm për të furnizuar. Vendosja e këtij kriteri është e rëndësishme për autoritetin, për të vërtetuar qëndrueshmërinë e ofertuesit, dhe besueshmërinë në përmbushjen e sukseshme të kontratës. Kërkesa e mësipërme, mbështetet me tëpër në një llogjikë të qartë dhe të thjeshtë, që konsiston në faktin që; automjeti për të furnizuar me karburant, nuk ka pse të përshkojë një distancë, jo të nevojshme vajtje-ardhje, duke humbur kështu kohë dhe gjithashtu duke rritur në mënyrë artificiale, jo produktive, konsumin e karburantit, duke qenë se Bashkia Divjake ka mjete që e kanë të nevojshme dhe të domosdoshme të punojnë gjatë gjithë vitit edhe jashtë territorit të saj.

2.4.3 Pika e shitjes së karburantit, duhet të jetë e pajisur me vërtetim teknik për respektimin e kushteve teknike të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial (ISHTI), Akt-Teknik/Certifikatë e mbrojtjes nga zjarri lëshuar nga PMNZSH (Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe e Shpëtimit) dhe Policë sigurimi në një nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri, për distributorët e shitjes me pakicë, të cilat duhet të jenë brenda afatit të vlefshmërisë në datën e hapjes së ofertave.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si edhe Vendimin Nr.491, datë 19.7.2017 “Për përcaktimin e rregullave, të kushteve teknike dhe normave të mirëmbajtjes së instalimeve nën presion, që shërbejnë për përpunimin, transportimin, depozitimin dhe tregëtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”. Vendosja e këtij kriteri, është e rëndësishme për autoritetin, për të vërtetuar qëndrueshmërinë e ofertuesit, dhe besueshmërinë në përmbushjen e sukseshme të kontratës.

2.4.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial (ISHTI), që subjekti ofertues ka importuar ose tregtuar karburante sipas standarteve të legjislationit Shqiptar, dhe nuk ka pasur penalitete për shkelje të cilesive për vitin e fundit.

Argumentim: Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK, që OE ofertues nuk është penalizuar nga autoritetet përkatëse për abuzim me cilësinë e karburanteve, duke ofruar një garanci se nuk do të ketë të tilla abuzime as me sasinë e karburantit të prokuruar. Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 44, të VKM-se Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe Vendimin Nr.491, datë 19.7.2017 “Për përcaktimin e rregullave, të kushteve teknike dhe normave të mirëmbajtjes së instalimeve nën presion, që shërbejnë për përpunimin, transportimin, depozitimin dhe tregtimin e naftës,të gazit dhe nënprodukteve të tyre”.

2.4.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë raport analize nga Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial (ISHTI) për mallin objekt prokurimi, ku vlerat e treguesve të analizuar të perputhen me vlerat në specifikimet e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Raport analiza nga ISHTI duhet të jetë lëshuar jo më parë se 6 (gjashtë) muaj nga dita e hapjes së ofertave.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si edhe në pikën 6/c, të nenit 40, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Raport analiza e karburantit, është një dokument i rëndësishëm, pasi dokumenton cilësinë e karburantit të tregtuar nga OE. Kjo garanci, lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të karburanteve të tregtuara. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë, i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për ofrimin e karburantit cilësor. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj duke përfshirë edhe specifikimet teknike, është kërkuar që të paraqitet raport analizimi për cilësinë e karburantit, lëshuar nga organi përkatës.

2.4.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë edhe deklaratat si më poshtë:

a) Subjekti duhet të deklarojë, se merr përsipër furnizimin me karburant, me pakicë, me shërbim 24 orë, për të gjitha mjetet e Bashkise Divjake, me kartë elektronike, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

b) Operatori ekonomik duhet të deklarojë, se do të mbulojë furnizimin me karburant, nëpërmjet kartave elektronike, për të gjithë sasinë e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

c) Subjekti duhet të deklarojë, se merr përsipër që të furnizojë të gjithë sasinë e litrave të ndodhura në kartën elektronike, si dhe pjesën e kërkuar nëpërmjet leshimit të tollonave, deri në përfundimin e plotë të kontratës, sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor. Kartat elektronike dhe tollonat, duhet të jenë pa skadencë dhe të jenë të përdorshme deri në përfundimin e levrimit të gjithë mallit përcaktuar në shtojcën 7.

d) Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të deklarojnë se ofrojnë një ndërfaqe menaxhimi të karburanteve (Web-page), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit për mjetet efektive të transportit, të kryhet nëpërmjet kartës elektronike. Kjo ndërfaqe e menaxhimit të karburanteve (Web-page), duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit të sasisë së karburantit nga Operatori Ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, dhe nga llogarija elektronike e AK në mjetet e transportit, me qëllim rimbushja e kartave elektronike të personalizuar me targën e mjetit si dhe administrimi i sasisë së karburanteve të kryhet nga vet Autoriteti Kontraktor. Ndërfaqja duhet të ofrojë edhe mundësinë e afishimit të disa raporteve, të cilat do të ndihmojnë AK për marrjen e vendimeve operacionale.

dh) Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ofrojë furnizimin me karburant me karta elektronike, të cilat duhet të jenë pa skadencë dhe të jenë të përdorshme dhe gjatë vitit 2025 në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.561 datë 29.07.2016 “*Per Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njesite e qeverisjes së përgjithshme*”.

Argumentim: Në bazë të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si edhe të VKM Nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë me ane të deklaratave, për të garantuar përmbushjen me sukses të kontratës nga OE dhe dhenia e sigurisë AK-se që kontrata do të realizohet sipas kërkesave të percaktuara në DST. Në bazë të nenit 77, të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si edhe nenit 40, pika 8, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë asetet elektronike të nevojshme për realizimin me sukses të kontratës sipas kërkesave të AK.

2.4.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të jetë i pajisur me certifikatat e mëposhtme:

Çertifikatën e cilësisë ISO 9001:2015 (Standard për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë)

Çertifikatën e cilësisë ISO 14001:2015 (Standart për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit)

(Certifikatat si më sipër duhet të paraqiten origjinale ose kopje të noterizuara, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë)

Vendosja e ISO 9001:2015 na shërben për të na treguar sistemin e administrimit të shoqërisë, zotësinë e operatorëve ekonomikë për zbatimin e kërkesave të vazhdueshëm të tij për të siguruar konformitetin në zbatimin e kërkesave. Disponimi i kësaj ISO-je rrit kompetivitetin, besueshmërinë dhe performancën e subjektit tregtar në treg, ndaj duke qenë se është e lidhur ngushtësisht me objektin e prokurimit dhe nuk kufizon konkurrencën, OE duhet ta paraqesin atë.

Vendosja e ISO 14001:2015 na shërben për shkak se është e lidhur me mjedisin. Angazhimi për mbrojtjen e mjedisit është një kriter madhor në zgjedhjen e një prodhuesi kurse metoda me e thjeshtë dhe me efikasitet për të shfaqur kujdes ndaj problemeve lidhur me mjedisin është zbatimi i një sistemi menaxhimi për mjedisin në konformitet me parashikimet e standartit ndërkombëtar ISO 14001. Perfitimet kryesore për këtë sistem menaxhimi janë: paraqitja e angazhimit për mbrojtjen e mjedisit nga klienti, komuniteti, zvogelimin e shpenzimeve nepermjet përmirësimit të administrimit mbeturinave dhe uljen e konsumit të burimeve, parandalimin e incidenteve të mundshme që mund të çojnë në pagesën për demshperblim dhe dëm, përmirësimin e marrëdhënieve me autoritetet. Për sa më sipër, vendosja e kësaj ISO është në proporcion me objektin që AK po prokuron.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në nenin 44, pika 1, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në të cilën parashikohet se:

Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit, si edhe në Ligjin Nr.116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se, Çertifikatat duhet të jenë lëshuar nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që AK të krijojë sigurinë që operatorët ekonomikë ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për të kryer shërbimin objekt kontrate. Në lidhje me kërkesën që OE ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatën e standartit si ISO, është menduar se, ky është një kriter i domosdoshëm për natyrën dhe vlerën e kontratës, të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit dhe në proporcion me të, me qëllim garantimin e realizimit në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standarteve ndërkombëtare të objektit të kontratës. Disponimi i ISO-s, rrit kompetivitetin, besueshmërinë dhe performancën e subjektit tregtar në treg, ndaj duke qenë se janë të lidhura ngushtësisht me objektin e prokurimit dhe nuk kufizojnë konkurrencën, OE duhet ta paraqesin atë.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

GAZOIL 10 ppm

Karburant (Gazoil) sipas S SH EN 590:2013 ose S SH EN 590:2013+A1:2017
ose të përditësuarat e tyre

Kërkesa të përgjithshme të zbatueshme dhe metodat e provave

Treguesi cilësor	Njësia e matjes	Kufijtë		Metoda e testimit
		Minimum	Maksimum	
1)-Numri i cetanit *		51	-	EN ISO 5165:2020 ASTM D 613
2)-Indeksi i cetanit *		46	-	EN ISO 4264:2018 ASTM D 976
3)-Densiteti në 15 °C *	kg/m ³	820	845	EN ISO 3675:1998 ASTM D 4052
4)-Hidrokarburët aromatikë policiklikë*	% (m/m)	-	8	EN 12916:2024 ASTM E 1655-05
5)-Përmbajtja e squfurit *	mg/kg	-	10	EN ISO 20846:2019
6)-Pika e flakërimit *	°C	55	-	EN ISO 2719:2016 ASTM D 93
7)-Mbetja e karbonit (në 10 % mbetje distilimi)*	% (m/m)	-	0,30	EN ISO 10370:2014
8)-Përmbajtja e hirit*	% (m/m)	-	0,010	EN ISO 6245:2002
9)-Viskoziteti në 40 °C *	mm ² /s	2,00	4,5	EN ISO 3104:2020 ASTM D 445-15

10)-Korrozioni ne shufer bakrit (3 orë në 50 °C) *	vlerësim	klasa 1		EN ISO 2160:1999
11)-Lubriceti ne 60°C *	µm	-	460	EN ISO 12156-1:2018
12)-Permbajtja e esterit metilik teacidit yndyror (FAME) *	% v/v	-	7	EN 14078:2014 ASTM D 7806
13)-Permbajtja e ujit *	% (m/m)	-	0.020	EN ISO 12937:2003
14)-Distilimi *:				EN ISO 3405:2019 ASTM D 86
- Destilati qe vlon deri ne 250 °C, % (v/v)	% (v/v)	-	65	
- Destilati qe vlon deri 350 °C, % (v/v)	% (v/v)	85	-	
- 95 % (v/v) destilon ne	°C	-	360	

BENZINË

Karburant Benzinë pa plumb sipas **S SH EN 228:2012+A1:2017**

Kërkesat të përgjithshme dhe metodat e provës për benzinën super pa plumb

Treguesi cilësor	Njësia e matjes	Kufijtë		Metoda e Testimit
		Minimum	Maksimum	
1)-Numri i oktanit kërkimor, RON *		95	-	EN ISO 5164:2014 ASTM D 2699-15
2)-Numri i oktanit motorrik, MON *		85		EN ISO 5163:2014 ASTM D 2699-15
3)-Densiteti (në 15 °C) *	kg/m ³	720	775	EN ISO 3675:1998 EN ISO 12185:1996 ASTM D 7777 ASTM D 4052
4)-Përmbajtja e squfurit *	mg/kg	-	10	EN ISO 20846:2019

5)-Distilimi *				
Distilon deri 70 °C	% (V/V)	20	48	EN ISO 3405:2019
Distilon deri 100 °C	% (V/V)	46	71	ASTM D 86
Distilon deri 150 °C	% (V/V)	75	-	
Pika finale e distilimit *	°C	-	210	
Mbetjet e distilimit *	% (V/V)	-	2	
6)-Korrozioni i shufrës së bakrit(3 orë në 50°C) *	Renditje	Klasa 1		EN ISO 2160:1999
7)-Tensioni i avujve te thate ekuivalent (DVPE)	KPa	45	100	EN 13016-1:2018
8)-Përmbajtja e tipit të hidrokarburit *				
- Olefinat *	% (V/V)	-	18	EN 238:1996/A1:2003 ASTM D 6277-07(2012)
- Aromatiket *		-	35	
9)-Përmbajtja e benzenit *	% (V/V)	-	1	EN 238:1996/A1:2006 ASTM D 6277-07(2012)
10)-Përmbajtja e oksigjenit *	% (m/m)	-	3,7	EN 238:1996/A1:2006 ASTM D 6277-07(2012)
11)-Përmbajtja e komponimeve oksigjenore *	% (V/V)			
- a)-Methanol (alkool metilik)		-	3	ASTM D 5845
- b)-Etanol (alkool etilik)		-	10	
- Alkool terc butil		-	15	
- Etere (me 5 ose më shumë atome C)	% (V/V)	-	22	
-				

Metodat E Provave / Testimit :te dhena e kerkuara ne medodat e testimiit jane vendosur bazuar ne metodat e testimiit te realizuara nga Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial (ISHTI) konforme standarteve mbi te cilat Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial (ISHTI) realizon keto analiza .

***Shënim:** Në kuptim të nenit 36 të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, pika 3/b, që specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve. AK pranon edhe mundësinë e paraqitjes së standardit SSH mbi konformitetin e standardit europian, dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Specifikimet teknike u hartuan nga specialistet e fushës, duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, në përputhje me përcaktimet e Nenit 36 “Specifikimet teknike” të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, e Nenit 40 pika 2, si edhe të

Nenit 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Argumentim: Në bazë, të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si edhe të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, për të garantuar përmbushjen me sukses të nevojës së AK-së, që kontrata do të realizohet sipas kërkesave, janë kërkuar specifikimet e mesipërme.

NJËSIA E PROKURIMIT